

IV PËRFITIMET E KEC-it

Ky projekt që implementohet nga KEC-i për vetë atë paraqet një aspekt shumë të rëndësishëm. Duke e realizuar atë, ka bërë që të fitohet një përvojë e re për shkollat që janë të përfshira në këtë program. I gjithë stafi është i njohur më drejtpërdrejt me gjendjen e shkollave, të personelit mësimdhënës dhe nxënësve. Kjo bën që në të ardhmen problemeve t'u qasemi më me seriozitet duke marrë për bazë përvojën e fituat.

Në kuadër të këtij projekti KEC ka botuar disa tekste (Udhëzues, të cilat i kemi paraqitur më lart) dhe ato janë për ne një pasuri shumë e çmueshme sepse është krijuar një bazë e mirë për vazhdimin e punës në programe të ngjashme.

Për KEC-in është shumë e rëndësishme nota tepër afirmative që është dhënë nga pjesëmarrësit e 10 shkollave pilot të përfshira në program. Kjo notë është 4.72 që rrallë ndodh në seminare të ngjashme të organizuara nga institucione të tjera. Gjithashtu edhe anketimet e bëra nga ana jonë me arsimtarë të përfshirë në projekt rezultojnë me përshtypje shumë pozitive. Psh. seminare të deritashme i vlerësojnë :

- a) të pasuksesshme 0%,
- b) të suksesshme 27%
- c) shumë të suksesshme 60%

(Më hollësisht për këto në raportin: Monitorimi deri në fund të dhjetorit 2001)

Në anën tjetër, për KEC-in është shumë pozitiv fakti se, trajnerët tanë kanë pasur mundësi që në bashkëpunim me kolegët nga Shqipëria, të përfitojnë përvojë relevante dhe kanë pasur mundësi që njohuritë e fituara gjatë trajnimeve në kuadër të KEC-it, t'i zbatojnë në praktikë. Madje, edhe ata vetë kanë përshtypje mjaft të mira për përvojën e fituar gjatë demonstrimit të mësimëve të zhvilluara gjatë seminareve.

A) Opinionet e trajnerëve të KEC-it

Naser Zabeli,
mësimdhënës
Në Fakultetin Filozofik,
Bashkëpunëtor në projekt
Të nxënët ndërveprues



"Si bashkëpunëtor në këtë projekt ("Të nxënët ndërveprues") më është dhënë rasti të fitoj përvojë të re dhe atë:

- duke vënë kontakte me persona të ndryshëm me eksperiencë në udhëheqje të projekteve për çështje të nduarnduarshme të arsimit;
- duke u njohur më drejtpërdrejt me problemet dhe personelin e dhjetë shkollave pilot të Kosovës (të përzgjedhura nga UNICEF-i);
- duke bashkëpunuar më ngushtë me drejtorë e arsimtarë tk këtyre shkollave, etj.

Puna në projektin "Të nxënët ndërveprues", paraqet sfidë dhe njëkohësisht kënaqësi për mua. Ky program ka bërë që personalisht të fitoj:

- shprehi pune,
- pavarësi në punë,
- ngritje të aftësisë menagjuese,
- ndërmarrje të iniciativave,
- kompletim të strategjive për të nxënët e nxënësve e të mësimdhënies etj.

Duke marrë për bazë përshtypjet e arsimtarëve, nxënësve, prindërve, trajnerëve si dhe rezultatet shumë pozitive të nxjerra nga raportet, analizat, anketimet etj. jam jashtëzakonisht i lumtur që ky program është vënë në jetë dhe po i jep shpirt e frymë të re arsimit kosovar.

Osman Gashi,
Mësimdhënës në Fakultetin
e Filologjisë,
Trajnues në Programin
Të nxënët ndërveprues



TË NDRYSHOJMË DHE TË NDRYSHOHEMI

*"Gjithçka do të jetë **ndryshe** tash e tutje"...*

*"Ka **ndryshuar** krejtësisht sistemi im i të menduarit"...*

*"Nxënësit e mi tash sillen **ndryshe**, ata janë më afër njëri tjetrit, ata e duan njëri tjetrin, ata janë më solidarë"...*

“Në shkollat tona po hyn një filozofi e re, e **ndryshme** nga tradicionalja, ta quajmë të tjerët si të duan, reformë, transformim, avansim...”

“Është kjo një dhuratë që na erdhi nga Perëndia...”

“Fëmija im mezi prët të shkojë në shkollë, kjo më parë rrallëherë ka ndodhur...”

Janë këto mbresa, përshtypje, gjykime çasti të nxënësve, mësuesve, prindërve si dhe të trajnuesve të rinj, të cilët sapo kanë filluar të marrin përgjegjësitë për zgjerimin e Projektit “TË NXËNËT NDËRVEPRUES” dhe të filozofisë së të menduarit kritik në arsimin kosovar.

Dhe fjala e parë që mund të dëgjohet më së shpeshti në çdo bisedë, debat a dialog me ata që janë futur në këtë lumë të pandalshëm është fjala **NDRYSHJE**. Është kjo esenca, emëruesi i përbashkët i tërë një procesi që ka filluar të implementohet në shkollat tona.

Ndonëse me vështirësitë e shumta, përçapjet fëmijnore dhe me bagazhin e vuajtjeve, të mundimeve, të tragjedive që i barti edhe shkolla jonë bashkë me tërë Kosovën, këtë **NDRYSHIM** ajo po e përjeton si një gjak të ri, i cili do t’i ndihmojë që më në fund të dalë nga letargjia.

A jemi vonuar?

A mund të arrijmë të kyçemi në sistemin global që aq shumë ka ecur përpara?

Të gjitha mund t’i arrijmë në qoftë se punojmë **ndryshe**, në qoftë se kërkojmë t’i **ndryshojmë** gjërat, para së gjithash ta ndryshojmë vetveten.

*Kur nxënësit janë të lirë për të menduar, duket **ndryshmëria** e opinioneve dhe ideve. Edhe një pyetje e vetme e saktë e lënë mënjanë, bën të shfaqen shumë mendime... Të përpiqesh për të kufizuar shprehjen e mendimeve, do të thotë të kufizosh mendimin e nxënësve. Për të lulëzuar mendimi kritik duhet të krijohet në klasë një mjedis, i cili bind nxënësit se janë të mirëpritur dhe të lejuar për një shtrirje të gjerë të opinioneve dhe të ideve. (J. L. Steele, K. S. Meredith, C. Temple).*

Abdullah Hoxha, prof.
Në shkollën e Mesme
në Prizren,
trajner në Programin
Të nxënët ndërvepres

"...Seminaret e mbajtura janë të një vlere të veçantë sidomos në ngritjen profesionale të mësimit. Veçanarisht do të potencojë dy drejtime kryesore ku ky program sollti tek unë ndryshime të mëdha:

- 1) Gjatë procesit të mësimit si mësues ndjehem më i sigurtë në realizimin e objektivave mësimore të orës, sepse vetë teknikat e ndryshme bashkëpunuese janë shumë motivuese dhe ndikojnë që nxënësit të jenë plotësisht të përfshirë në nxënje e cila rrjedh natyrshëm...Nxënësit ndiejnë kënaqësi dhe argëtim gjatë të nxënimit me këto teknika.
- 2) Në raport me kolegë ky program më ndihmoi të jem një këshillues dhe mësues shembull. Shumë kolegë nga dëshira që të arrijnë suksese të tilla me nxënës, me vetëdëshirë vijnë të marrin pjesë në orët mësimore ku jap mësim dhe të gjithë me admirim e shohin punën time...dhe me kënaqësi presin të kyçen në të ardhmen në trajnime të këtilla."

Milike Maliqi,
arsimtare në shkollën fillore
në Ferizaj,
trajner në Programin
Të nxënët ndërvepres

"...Për nxënësit mësimi sipas këtij programi sjell kënaqësi sepse shprehin lirisht mendimet e tyre, diskutojnë problemet, japin vlerësimet e tyre...

...Kisha fatin që të jem në mesin e 12 kolegëve që përhapin këtë projekt. Natyrisht se puna më të rritur është më e vështirë e sidomos fillimi por me kalimin e kohës fituam sigurinë në vetvete, shprehjen e mendimeve më lehtë se përpara, komunikimi me pjesëmarrës e shumë gjëra të tjera që ndoshta dikujt do t'i dukeshin të parëndësishme."